

VENDIM
Nr. 490, datë 21.7.2022

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E
RIKONSTRUKSIONIT DHE RIPARIMIT TË MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI
OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKINË MIRDITË**

(Ndryshuar me VKM nr. 679, datë 6.12.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 215 993 495 (dyqind e pesëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit ose riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Mirditë.

2. Përdorimin e fondit, për vitin 2022, nga Bashkia Mirditë, në masën 43 198 699 (dyzet e tre milionë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë, miratuar për vitin 2022, dhe t’i transferohet Bashkisë Mirditë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2023, nga Bashkia Mirditë, në masën 146 888 754 (njëqind e dyzet e gjashtë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit dhe riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Mirditë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, dhe i transferohet Bashkisë Mirditë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama